



SHERBIMI SOCIAL

TAKIMET PËRMBYLLËSE ME ADMINISTRATORËT SHOQËRORE



Gjatë muajit Mars 2023 Drejtoresha e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror znj. Xholi ka përfunduar turin e takimeve me Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror dhe administratorët shoqëror të pushtetit vendor.

Këtë muaj u zhvilluan takimet në Elbasan dhe Berat, të cilat i shërbyen diskutimit të problematikave të punës së përditshme dhe adresimit në kohë reale të problematikave të qytetarëve.

#8 MARS

Në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me Ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale znj. Manastirliu dhe Kryetarin e Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj zhvilluam një takim me nënat me më shumë se tri fëmijë të cilat prej Janarit 2023 janë përfituese të Programit të Mbështetjes së Qeverisë për Nënata me më shumë si tri fëmijë.

Prej muajit Janar 2023 në Bashkinë Tiranë janë mbështetur nga ky program 700 nëna të papuna me tri fëmijë, të cilave po u subvencionohen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.





SHERBIMI SOCIAL

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE



Gjatë muajit Mars 2023 Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 5 raste viktime trafikimi ose viktime të mundshme të trafikimit, si edhe 3 raste dhune.

Janë zhvilluar komisionimet për sistemim në institucione të përkujdesit shoqëror, nga të cilat janë sistemuar 4 fëmijë, 1 i moshuar, 1 fëmijë me aftësi ndryshe, si edhe janë rinovuar 28 librezat të Statusit të Jetimit.

#14 MARS NË INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Në traditën tonë shqiptare 14 marsi shënon ditën e rëndësishme të verës dhe përtëritjes së natyrës. Sikur ndër të gjitha ditët e tjera të festave zyrtare, atmosfera e kësaj feste ka ardhur në mënyra të ndryshme në të gjitha institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijë, të moshuar, PAK etj.

Gjyshërit energjikë të Qendrës Polivalente Ditore Kamëz kaluan një super ditë ashtu si ata janë, energjike dhe me diell, në Elbasanin mikpritës të kësaj feste.